



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

RAPORT PËRMBLEDHËS PËR PYETËSORËT E REALIZUAR ME PALËT E JASHTME TË INTERESIT

Zyra për Sigurim të Cilësisë

Institucioni: Kolegji BIZNESI

Viti akademik: 2023-24

Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	3
Hyrja.....	4
Zyra për Sigurim të Cilësisë.....	5
1. Qëllimi iRaportit.....	6
2. Metodologjia e Vlerësimit.....	6
3. Analiza Përmbledhëse e Rezultateve tëVlerësimit.....	17
Rekomandimet.....	21

Lista e shkurtesave

IAL: Institucion i Arsimit të Lartë

KSCV: Komisioni për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimit

SMK: Sistemi i Menaxhimit në Kolegj

KB: Kolegji Biznesi

ZSC: Zyra për Sigurim të Cilësisë

Hyrje

Kolegji Biznesi, si Institucion i Arsimit të Lartë i themeluar në vitin 2004, në mënyrë të vazhdueshme ka ndërmarrë veprime konkrete për ta bërë të matshëm dhe të dokumentueshëm procesin e sigurimit të cilësisë, duke përfshirë edhe bashkëpunimin sistematik me partnerët e industrisë. Në këtë kuadër, përveç pyetësorëve të rregullt me studentët dhe stafin akademik, Kolegji Biznesi realizon edhe pyetësorë të posaçëm me përfaqësues të industrisë dhe tregut të punës, me qëllim të vlerësimit të relevancës së programeve studimore, kompetencave të të diplomuarve dhe nivelit të bashkëpunimit institucion–industri.

Pyetësori me industrinë është hartuar për të reflektuar perceptimet dhe vlerësimet e akterëve ekonomikë lidhur me përputhshmërinë e programeve studimore me nevojat reale të tregut të punës, aftësitë profesionale dhe praktike të studentëve dhe të diplomuarve, si dhe mundësitë për thellimin e bashkëpunimit në fusha të tilla si praktikat profesionale, ligjëratat nga ekspertë të industrisë, projektet e përbashkëta dhe punësimi i të diplomuarve.

Kolegji Biznesi disponon mekanizma të qartë dhe funksionale për matjen dhe monitorimin e cilësisë, ku procesi mbikëqyret dhe analizohet në mënyrë të vazhdueshme nga menaxhmenti i institucionit, përfshirë Dekanin, Prodekanët, Përgjegjësit e Programeve Studimore dhe Koordinatorët për Cilësi, Zyra për Sigurim të Cilësisë në Kolegjin Biznesi, Prishtinë, ka rol kyç në organizimin, administrimin dhe analizimin e këtij procesi dhe përbën organin kryesor institucional për sigurimin e cilësisë së brendshme.

I gjithë procesi i hartimit të pyetësorit, shpërndarjes së tij dhe mbledhjes së të dhënave është realizuar nga Zyra për Sigurim të Cilësisë, në koordinim të plotë me strukturat përkatëse institucionale. Procesi është zhvilluar në mënyrë transparente dhe konfidenciale, duke garantuar anonimitetin e respondentëve nga industria dhe duke respektuar standardet etike dhe profesionale të bashkëpunimit institucional.

Me qëllim të ruajtjes së etikës profesionale, konfidencialitetit të respondentëve dhe prestigjit të institucionit, në këtë raport paraqiten vetëm gjetjet kryesore dhe përmbledhëse të pyetësorit. Rekomandimet, si pjesë përmbyllëse e raportit, përfshijnë sugjerime dhe vërejtje të rëndësishme të dhëna nga përfaqësuesit e industrisë, të cilat shërbejnë si bazë për përmirësime të mëtejshme strategjike dhe nuk publikohen në mënyrë të detajuar.

Zyra për Sigurim të Cilësisë

Zyra për Sigurim të Cilësisë është njësi funksionale e pavarur që vepron brenda strukturës institucionale të Kolegjit Biznesi, dhe raporton drejtpërdrejt te organet drejtuese të institucionit, në përputhje me aktet e brendshme dhe rregulloret në fuqi. Zyra për Sigurim të Cilësisë angazhohet në rritjen e vazhdueshme të cilësisë akademike dhe institucionale në Kolegjin Biznesi, duke zbatuar politikat e miratuara institucionale dhe instrumentet për matjen e cilësisë, të aprovuara nga Komisioni për Sigurim të Cilësisë (KSC).

Zyrtarët e cilësisë veprojnë në mënyrë të pavarur nga stafi akademik dhe nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në procesin e mësimdhënies, duke garantuar objektivitet dhe paanshmëri në procesin e vlerësimit. Zyra realizon matjen e cilësisë duke përdorur instrumentet standarde të përfshira në paketën institucionale të instrumenteve për sigurim të cilësisë, të miratuara nga KSC.

Zyra për Sigurim të Cilësisë harton raporte analitike që përmbajnë gjetje dhe rekomandime për secilin pyetësor apo proces vlerësimi të realizuar, të cilat i adresohen menaxhmentit të institucionit dhe organeve përkatëse vendimmarrëse. Po ashtu, gjetjet dhe rekomandimet i dërgohen përgjegjësve të programeve studimore dhe njësive akademike, me qëllim të planifikimit të zhvillimit profesional të stafit akademik dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve studimore.

Realizimi i pyetësorit

Pyetësori me palët e jashtme të interesit realizohet një herë në vit në Kolegjin Biznesi, në koordinim me të gjitha njësitë akademike përmes koordinatorëve për sigurim të cilësisë në kuadër të programeve studimore. Ky instrument shërben për të vlerësuar nivelin e bashkëpunimit institucional me industrinë dhe për të siguruar feedback të drejtpërdrejtë nga tregu i punës lidhur me cilësinë dhe relevancën e programeve studimore.

Procesi i realizimit ka qenë anonim dhe konfidencial, ndërsa të dhënat janë mbledhur, administruar dhe ruajtur nga **Zyra për Sigurim të Cilësisë (ZSC)**.

Palët e jashtme të interesit kanë marrë pjesë në pyetësor përmes një pyetësori online (link elektronik), i cili ka qenë i integruar me sistemin institucional të Kolegjit. Pyetësori ka përfshirë gjithsej **9 pyetje të mbyllura dhe 6 pyetje të hapura**, të cilat kanë synuar vlerësimin e aspekteve kryesore të bashkëpunimit ndërmjet Kolegjit Biznesi dhe industrisë, si dhe përshtatshmërinë e aftësive dhe kompetencave të studentëve me kërkesat e tregut të punës.

Në mënyrë të veçantë, pyetjet kanë pasur për qëllim vlerësimin e këtyre elementeve kryesore:

- punësimi dhe angazhimi profesional i studentëve dhe të diplomuarve;
- përgatitja e studentëve për karrierë dhe tregun e punës;
- aftësitë dhe shkathtësitë profesionale të fituara gjatë studimeve;
- nevoja për lëndë të reja dhe programe studimore të përshtatura me zhvillimet e tregut;
- niveli i bashkëpunimit institucional me Kolegjin Biznesi;
- fushat potenciale të bashkëpunimit me industrinë;
- sugjerimet dhe komentet për përmirësimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dhe programeve studimore.

Gjetjet e pyetësorit

Pyetësori me palët e jashtme të interesit është realizuar përmes Sistemit elektronik, në koordinim me njësitë akademike të Kolegjit Biznesi. Procesi ka gjeneruar komente dhe sugjerime të vlefshme, duke reflektuar interesim për bashkëpunim të mëtejshëm me institucionin.

Në pyetësor kanë marrë pjesë institucione publike dhe private, kryesisht biznese me përvojë shumëvjeçare në treg. Gjetjet tregojnë se palët e jashtme vlerësojnë pozitivisht misionin e Kolegjit Biznesi dhe përgatitjen profesionale të studentëve. Një pjesë e konsiderueshme e respondentëve kanë deklaruar punësim të të diplomuarve nga Kolegji Biznesi dhe nivel të kënaqshëm performance në punë.

Në përgjithësi, rezultatet tregojnë nivel të lartë kënaqshmërie dhe konfirmojnë rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit ndërmjet Kolegjit Biznesi dhe industrisë.

Metodologjia e Vlerësimit

Vlerësimi i Kolegjit BIZNESI është realizuar përmes një procesi të strukturuar dhe sistematik, duke përdorur një instrument të standardizuar të mbledhjes së të dhënave, i cili konsiston në një pyetësor me 16 pyetje të dizajnuara për të matur perceptimin e industrisë mbi cilësinë e mësimdhënies, organizimin akademik dhe materialet mësimore të përdorura gjatë mësimdhënies. Ky instrument është konceptuar duke u bazuar në praktikat më të mira rajonale dhe ndërkombëtare për vlerësimin e cilësisë akademike në arsimin e lartë.

Pyetësi përfshin dimensione të ndryshme të procesit mësimor, të cilat janë thelbësore për një analizë të gjithanshme dhe të integruar të cilësisë së korrikulave.

Për vitin 2023, ky instrument u aplikua në mënyrë të njëjtë, duke siguruar krahasueshmëri të rezultateve me vitet e mëparshëm dhe duke mundësuar një pasqyrë të vazhdueshme mbi perceptimet e industrisë gjatë gjithë vitit akademik.

Dimensionet e vlerësuara përfshijnë: Nga 1 deri në 5 (1 2 3 4 5)

1. Sa të përgatitur mendoni se janë studentët e programeve për të filluar punë në sektorin e menaxhmentit dhe ekonomisë?


Sa të përgatitur mendoni se janë studentët e programeve për të filluar punë në sektorin e menaxhmentit dhe ekonomisë? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)

Nga përgjigjëjet e marrura nga industria rezulton që studentet e diplomuar pranë Kolegjit Biznesi kanë përgatitje të kënaqshme duke vlersur me notën 4 pra një vlersim motivues por edhe nxitës per institucionin e Kolegjit Binzesi.

Tabela.1 Sa të përgatitur mendoni se janë studentët e programeve për të filluar punë në sektorin e menaxhmentit dhe ekonomisë? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)

Nr.i vlersimit	1. Sa të përgatitur mendoni se janë studentët e programeve për të filluar punë në sektorin e menaxhmentit dhe ekonomisë? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)	Vlersimi
1	Pamjaftueshëm	0
2	Mjaftueshëm	0
3	Mirë	3
4	Shumë mirë	7
5	Shkëlqyeshëm	5
	Totali	15

Grafiku.1 Sa të përgatitur mendoni se janë studentët e programeve për të filluar punë në sektorin e menaxhmentit dhe ekonomisë? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)



2. A mendoni se njohuritë teorike të fituara në programe janë të përshtatshme për kërkesat reale të industrisë?


Sa të përgatitur mendoni se janë studentët e programeve për të filluar punë në sektorin e menaxhmentit dhe ekonomisë? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)

Industria ka dhënë vlersim superlative pra me notë maksimale (5) për Kolegjin Biznesi duke vlersuar me notë maksimale korrikulën dhe edukimin që marrin studentët pranë Kolegjit Biznesi njëherit bashkpunimin që ka Kolegji Biznesi me industrinë.

Tabela.2 A mendoni se njohuritë teorike të fituara në programe janë të përshtatshme për kërkesat reale të industrisë? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)

Nr.i vlersimit	2. A mendoni se njohuritë teorike të fituara në programe janë të përshtatshme për kërkesat reale të industrisë? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)	Vlersimi
1	Pamjaftueshëm	0
2	Mjaftueshëm	0
3	Mirë	2
4	Shumë mirë	3
5	Shkëlqyeshëm	10
	Totali	15

Grafiku.2 A mendoni se njohuritë teorike të fituara në programe janë të përshtatshme për kërkesat reale të industrisë? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)




3. Sa efektiv janë programet në zhvillimin e aftësive praktike të studentëve për situata reale punë? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)

Nga vlersimi i industrisë kuptojmë që programet jepen kompetencë të konsiderueshme për ekonominë e tregut dhe komunitetin në përgjithësi pra me vlerësim maksimal (5).

Tabela.3 Sa efektiv janë programet në zhvillimin e aftësive praktike të studentëve për situata reale punë? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)

Nr.i vlersimit	3. Sa efektiv janë programet në zhvillimin e aftësive praktike të studentëve për situata reale punë? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)	Vlersimi
1	Pamjaftueshëm	0
2	Mjaftueshëm	0
3	Mirë	1
4	Shumë mirë	5
5	Shkëlqyeshëm	9
	Totali	15

Grafiku.3 Sa efektiv janë programet në zhvillimin e aftësive praktike të studentëve për situata reale punë? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)




4. Sa të aftë janë studentët në zgjidhjen e problemeve të biznesit dhe vendimmarrje? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)

Industria jep një vlerësim relativisht të mirë për studentët e Kolegjit Biznesi në vendin e punës me notë relativisht të lartë pra me notë 4 që na motivon edhe më shumë që të punojm më shumë për kuadro sa më të përgatitur për tregun e punës.

Tabela.4

Nr.i vlersimit	4. Sa të aftë janë studentët në zgjidhjen e problemeve të biznesit dhe vendimmarrje? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)	Vlersimi
1	Pamjaftueshëm	0
2	Mjaftueshëm	0
3	Mirë	1
4	Shumë mirë	11
5	Shkëlqyeshëm	3
	Totali	15

Grafiku.4 Sa të aftë janë studentët në zgjidhjen e problemeve të biznesit dhe vendimmarrje? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)




5. A ju duket se studentët kanë aftësi të mira për analizë të të dhënave dhe interpretim ekonomik? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)

Nga përgjigjëjet e industrisë vlersojnë që studentët kanë njohuri të mjaftueshme për analiza dhe interpretim ekonomik pra me vlerësim katër (4), një vlerësim i pranueshëm për nivelin e edukimit.

Tabela.5 A ju duket se studentët kanë aftësi të mira për analizë të të dhënave dhe interpretim ekonomik? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)

Nr.i vlersimit	5. A ju duket se studentët kanë aftësi të mira për analizë të të dhënave dhe interpretim ekonomik? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)	Vlersimi
1	Pamjaftueshëm	0
2	Mjaftueshëm	0
3	Mirë	1
4	Shumë mirë	11
5	Shkëlqyeshëm	3
	Totali	15

Grafiku.5 A ju duket se studentët kanë aftësi të mira për analizë të të dhënave dhe interpretim ekonomik? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)




6. A ndihmojnë programet studentët të zhvillojnë aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi në ekip? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)

Nga përgjigjet e marrura nga industria dëshmon që program i plotëson kërkesat e komunitetit për faktin që programet përmbajnë lëndë për menagjim dhe negocim duke e cilësuar lart vlersimin për studentët pra me vlersim pesë (5).

Tabela.6 A ndihmojnë programet studentët të zhvillojnë aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi në ekip? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)

Nr.i vlersimit	6. A ndihmojnë programet studentët të zhvillojnë aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi në ekip?	Vlersimi
1	Pamjaftueshëm	0
2	Mjaftueshëm	0
3	Mirë	1
4	Shumë mirë	2
5	Shkëlqyeshëm	12
	Totali	15

Grafiku.6 A ndihmojnë programet studentët të zhvillojnë aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi në ekip? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)




7. A mendoni se studentët janë të aftë për të menaxhuar projekte reale dhe iniciativa biznesi? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)

Industria ka dhënë një vlerësim relativisht të lartë pra të kënaqshëm ku studentët mund të kyqen në projekte të larta edhe nëse nuk janë lidër mund të kontribuojn në çdo projekt pra një vlerësm katër (4).

Tabela.7 A mendoni se studentët janë të aftë për të menaxhuar projekte reale dhe iniciativa biznesi? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)

Nr.i vlersimit	7. A mendoni se studentët janë të aftë për të menaxhuar projekte reale dhe iniciativa biznesi. (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)	Vlersimi
1	Pamjaftueshëm	0
2	Mjaftueshëm	0
3	Mirë	1
4	Shumë mirë	13
5	Shkëlqyeshëm	1
	Totali	15

Grafiku.7 A mendoni se studentët janë të aftë për të menaxhuar projekte reale dhe iniciativa biznesi? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)




8. Sa të efektshëm janë programet në zhvillimin e aftësive për mendim kritik dhe inovacion? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)

Se sa të efektshme janë programet për të përgatitur studentët për mendim kritik dhe inovacion nga industria kemi marrur vlerësim të lartë pra vlerësim me notë 5 duke i cilësuar studentët e Kolegjit Biznesi me përgatitje të larta në raport me tregun e punës.

Tabela.8 Sa të efektshëm janë programet në zhvillimin e aftësive për mendim kritik dhe inovacion? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)

Nr.i vlersimit	8. Sa të efektshëm janë programet në zhvillimin e aftësive për mendim kritik dhe inovacion? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)	Vlersimi
1	Pamjaftueshëm	0
2	Mjaftueshëm	0
3	Mirë	0
4	Shumë mirë	1
5	Shkëlqyeshëm	14
	Totali	15

Grafiku.8. Sa të efektshëm janë programet në zhvillimin e aftësive për mendim kritik dhe inovacion? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)




9. A ofrojnë programet mundësi të mjaftueshme për praktikë, internship ose bashkëpunim me kompani? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)

Nga përgjigjëjet e marrura nga industria vlerësojnë studentët me notë 4, pra një vlerësim relativisht i lartë për gadishmërinë e studentëve të Kolegjit Biznesi për nivelin e bashkëpunimit dhe gadishmërisë së studentëve për treg të punës.

Tabela.9 A ofrojnë programet mundësi të mjaftueshme për praktikë, internship ose bashkëpunim me kompani? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)

Nr.i vlersimit	9. A ofrojnë programet mundësi të mjaftueshme për praktikë, internship ose bashkëpunim me kompani? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)	Vlersimi
1	Pamjaftueshëm	0
2	Mjaftueshëm	0
3	Mirë	3
4	Shumë mirë	11
5	Shkëlqyeshëm	1
	Totali	15

Grafiku.9 A ofrojnë programet mundësi të mjaftueshme për praktikë, internship ose bashkëpunim me kompani? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)




10. Çfarë ndryshimesh ose përmirësimesh do të rekomandonit për programet për ti bërë më të përshtatshëm për industrinë? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)

Nga vlerësimi i industrisë në raport me studentët e Kolegjit Biznesi rekomandojnë që studentët të fokusohen në praktikë me qëllim që të jenë më operativ në detyrat e punës që i marrin në momentin e angazhimit në tregun e punës.

Tabela.10 Çfarë ndryshimesh ose përmirësimesh do të rekomandonit për programet për ti bërë më të përshtatshëm për industrinë? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)

Nr.i vlersimit	10. Çfarë ndryshimesh ose përmirësimesh do të rekomandonit për programet për ti bërë më të përshtatshëm për industrinë? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)	Vlersimi
1	Pamjaftueshëm	0
2	Mjaftueshëm	0
3	Mirë	3
4	Shumë mirë	9
5	Shkëlqyeshëm	3
	Totali	15

Grafiku.10 Çfarë ndryshimesh ose përmirësimesh do të rekomandonit për programet për ti bërë më të përshtatshëm për industrinë? (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)



Industria ka dhënë përgjigje në një shkallë me pesë nivele, ku 1 korrespondon me "shumë i pakënaqur" dhe 5 me "shumë i kënaqur". Ky sistem i vlerësimit lejon një matje të kuantifikueshme të perceptimeve dhe përqendrimin në aspekte të veçanta të cilësisë akademike. Përpunimi i të dhënave është realizuar duke llogaritur mesataren e përgjigjeve të pyetsorit, për të siguruar që rezultati pasqyron vlerësimin real të pjesëmarrësve.

Përveç analizës kuantitative, ky proces ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të hollësishme mbi perceptimet e industrisë, duke identifikuar praktikën më të suksesshme të Kolegjit Biznesi dhe fushat që mund të përmirësohen. Ky nivel detajimi mundëson që programet studimore Bachelor të avancojnë në standardet e cilësisë akademike dhe të kontribuojë në përmirësimin e përvojës akademike të studentëve brenda Kolegjit të Biznesit.

Analiza Përmbledhëse e Rezultateve të Vlerësimit

Kjo pjesë e raportit ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të integruar, të detajuar dhe krahasuese të perceptimeve të industrisë mbi cilësinë e mësimdhënies, strukturën akademike dhe materialet mësimore të përdorura në programet e Kolegjit Biznesi – Bachelor gjatë vitit 2023. Përmes këtij seksioni, prezantohen trendet e përgjithshëm të performancës së programeve, dimensionet më të forta të programet dhe fushat që ofrojnë mundësi për përmirësim, duke reflektuar standardet akademike të Kolegjit të Biznesit dhe praktikën më të mira ndërkombëtare në arsimin e lartë.

Të dhënat për këtë analizë janë mbledhur përmes pyetësorit standard me 10 pyetje, i dizajnuar për të matur perceptimet e industrisë mbi cilësinë e programeve, qartësinë e objektivave, përgatitjen dhe përdorimin e materialeve mësimore, metodologjitë didaktike dhe gatishmërinë e mësimdhënësve për mbështetje akademike. Secila pyetje kontribuon në formimin e një vlerësimi të integruar për secilin program, duke lejuar një analizë të saktë dhe kuantifikueshme.

Përpunimi i të dhënave është realizuar duke llogaritur mesataret për secilin program, gjë që garanton që rezultatet pasqyrojnë perceptimet reale të industrisë.

Kjo qasje analitike mundëson identifikimin e modeleve të performancës së programeve dhe evidentimin e elementeve të suksesit, si dhe fushave që kërkojnë vëmendje dhe përmirësim. Përveç vlerësimit numerik, raporti synon të nxjerrë njohuri të vlefshme strategjike për menaxhimin e programeve dhe për avancimin e cilësisë akademike në mënyrë të qëndrueshme.

Kjo pjesë përfshin një krahasim të rezultateve midis vitve të kaluara, duke identifikuar trendet e përparimit, dimensionet më të forta dhe fushat që mund të fuqizohen përmes metodave interaktive dhe materialeve digjitale të avancuara. Analiza krahasuese lejon të evidentohen praktikën më të suksesshme dhe strategjitë e përshtatshme për zhvillimin profesional të stafit akademik, si dhe për rritjen e përfshirjes dhe angazhimit të studentëve.

Në përputhje me standardet akademike, kjo analizë thekson rëndësinë e monitorimit të vazhdueshëm të cilësisë akademike, duke u fokusuar jo vetëm në rezultate numerike, por edhe në identifikimin e praktikave më të mira dhe inovative të mësimdhënies. Rezultatet e paraqitura në këtë seksion shërbejnë si bazë për vendimmarrje strategjike, përmirësimin e metodave të mësimdhënies, integrimin e materialeve digjitale, dhe implementimin e praktikave interaktive që rrisin aftësitë analitike, kritike dhe profesionale të studentëve.


Kjo qasje e integruar dhe e detajuar siguron që prograet e Kolegjit Biznesi – Bachelor të ruajnë dhe avancojë standardet e tyre akademike, duke e bërë programet të përshtatshme për sfidat e tregut profesional dhe kërkesat e zhvillimit të aftësive kërkimore dhe menaxheriale në nivel të lartë.

Për të vizualizuar në mënyrë më të qartë performancën e lëndëve dhe perceptimet e industrisë për programet, grafikat dhe tabelat e mëposhtme paraqesin mesataret e vlerësimeve për programet e Kolegjit Biznesi. Këto paraqitje grafike lehtësojnë identifikimin e programeve me rezultate më të larta dhe dimensioneve më të forta, si dhe evidentojnë fushat ku mund të ndërmerren masa për përmirësim, duke mundësuar një analizë komparative dhe sintetike të performancës së programeve të Kolegjit Biznesi.

Tabela përmbledhëse11: Mesatarja e Vlerësimit të programeve vitit 2023 (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)

Anketimi i Industrisë		
N r	Përshkrimi i pytyës	Vlerësim i
1	Sa të përgatitur mendoni se janë studentët e programit për të filluar punë në sektorin e menaxhmentit dhe ekonomisë?	4
2	A mendoni se njohuritë teorike të fituara në program janë të përshtatshme për kërkesat reale të industrisë?	5
3	Sa efektiv është programi në zhvillimin e aftësive praktike të studentëve për situata reale pune?	5
4	Sa të aftë janë studentët në zgjidhjen e problemeve të biznesit dhe vendimmarrje? *	4
5	A ju duket se studentët kanë aftësi të mira për analizë të të dhënave dhe interpretim ekonomik?	4
6	A ndihmon programi studentët të zhvillojnë aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi në ekip?	5
7	A mendoni se studentët janë të aftë për të menaxhuar projekte reale dhe iniciativa biznesi?	4
8	Sa i efektshëm është programi në zhvillimin e aftësive për mendim kritik dhe inovacion? *	5
9	A ofron programi mundësi të mjaftueshme për praktikë, internship ose bashkëpunim me kompani?	4
10	Çfarë ndryshimesh ose përmirësimesh do të rekomandonit për programin për ta bërë më të përshtatshëm për industrinë	4

Grafiku 1: Mesatarja e Vlerësimit të programeve vitit 2023 (kanë marrë pjesë 15 të anketuar)



Ky grafik paraqet mesataret e vlerësimeve për programet e Kolegjit Biznesi -Bachelor. Vlerësimet e industrisë me mesatare më të lartë tregojnë perceptim të lartë mbi qartësinë e koncepteve, strukturën logjike të ligjëratave, përdorimin e shembujve praktikë dhe gatishmërinë e mësimeve për mbështetje individuale. Vlerësimet më të ulëta, megjithatë mbi nivelin e kënaqësisë, sugjerojnë hapësira për rritje të interaktivitetit, diskutimeve dhe përdorimin e materialeve digjitale më të avancuara. Ky vizualizim lejon një krahasim të performancës së programeve dhe identifikimin e fushave ku mund të ndërmerren masa për përmirësim, duke siguruar një bazë të qartë për zhvillimin profesional dhe avancimin e cilësisë akademike.

Bazuar në mesataret e vlerësimeve për vitin 2023, mund të nxjerrim disa vëzhgime kryesore që ofrojnë një pamje të integruar të performancës së programeve të Kolegjit Biznesi - Bachelor dhe perceptimeve të industrisë mbi cilësinë akademike:

1. ***Performanca e lartë e të gjitha programeve*** – Të gjitha programet e vlerësuara kanë marrë mesatare mbi 4.5, duke treguar një nivel të lartë kënaqësie nga industria. Ky rezultat reflekton se korrikula e programeve, metodat e mësimit dhe organizimi akademik janë në përputhje të mirë me pritshmëritë e industrisë, duke siguruar një përvojë akademike efektive dhe të qëndrueshme.
2. ***Dimensionet më të vlerësuara nga industria*** – Industria evidentuan disa elementë kyç të cilësisë akademike: qartësinë e objektivave, përdorimin e shembujve praktikë, gatishmërinë dhe qasjen profesionale të mësimeve, si dhe përfshirjen e resurseve digjitale dhe materialeve mbështetëse. Këto dimensionet kontribuojnë në një proces mësimor të suksesshëm dhe zhvillimin e aftësive analitike dhe praktike të studentëve.
3. ***Fushat me potencial për përmirësim*** – programet me mesatare më të ulët, megjithatë mbi 4.5, evidentojnë hapësira për zhvillim, veçanërisht në drejtim të rritjes së interaktivitetit gjatë ligjëratave dhe përdorimit të materialeve digjitale dhe aplikative të avancuara. Aktivitetet praktike, diskutimet më të strukturuar dhe metodat interaktive mund të rrisin pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe të thellojnë kuptimin e përmbajtjes akademike.
4. ***Impakti i perceptimeve mbi zhvillimin profesional*** – Vlerësimet e industrisë ofrojnë informacion të vlefshëm për planifikimin e zhvillimit profesional të programeve akademike dhe për adaptimin e praktikave të mësimit në përputhje me trendet moderne. Analiza e këtyre të dhënave mundëson identifikimin e praktikave të suksesshme që mund të konsolidohen dhe të standardizohen për të gjithë programet, si dhe ofron rekomandime për përmirësime konkrete ku është e nevojshme.
5. ***Kuptimi i përgjithshëm i rezultateve*** – Rezultatet e vitit 2023 reflektojnë një performancë të lartë dhe të qëndrueshme të programeve, me fokus të qartë në cilësinë e mësimit, zhvillimin e aftësive të studentëve dhe përdorimin efektiv të metodave didaktike. Kjo pasqyrë e integruar ndihmon në monitorimin e performancës së programeve dhe planifikimin e përmirësimeve strategjike për semestrat e ardhshëm.

Rekomandimet

Zyra e cilësisë e Kolegjit Biznesi, pasi që ka shqyrtuar përgjigjet e palëve të jashtme të interesit, në këtë fazë të zhvillimit të institucionit, i rekomandon menaxhmentit të lartë të Kolegjit Biznesi që të merren hapat si më poshtë:

1. Të analizohen me kujdesë nevojat dhe kërkesat e palëve të jashtme të interesit për lëndë dhe praktika konform kërkesave të ekonomisë së tregut dhe komunitetit;
2. Të arrihen sa më shumë marrëveshje me palë të jashtme, vendore dhe ndërkombëtare për të mundësuar praktikë dhe punësim të studentëve;
3. Të rritet kontributi për komunitetin përmes iniciativave të ndryshme;
4. Të intensifikohen hulumtimet shkencore dhe bashkpuimet institucionale me institucione relevante vendore, rajonale dhe ndërkombëtare ;
5. Realizimi i vizitave me student në biznese dhe institucione relevante me qëllim të rritjes së përgatitjeve për treg të punës;